

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një gjyq kundër kombit shqiptar - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/nje-gjyq-kunder-kombit-shqiptar
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 18:59:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 18:55:45 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5440dc69585a04930e6e37339b583aa23b0c1d0069b39084b608bffa76a56fb
TEKSTI	6be5c2dda971ff3fa0ba245d2d2adf373f9a574513153fc6b1040a59b80a4793
PAMJA	c9914c19afa7e1715502fe203fe5997113e92a321e5d65204a21d40f9395cf5f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4ee25ba5b04edcf981af7fc33f381026491e60256bcc5f768c2b1af6d30c8260
E MËPARSHMJA	447baaf334b8ec3a7ba9c37477f62ce7db450ee5375adda4276901c733f67aa7
RRËNJA MERKLE	9f13708d4cb43333cd442efe7c96fa8554969483459094e5d4825bc5f113135
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4ee25ba5b04edcf981af7fc33f381026491e60256bcc5f768c2b1af6d30c8260>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Itali/ U vra teksta hyri për të vjedhur në shtëpi, publikohet audio e pronarit: E qëllonve sepse u frikësua



Opinion

Një gjyq kundër kombit shqiptar

Mjerimi i vendimeve të Gjykatës së Hagës, cilësohet i tillë sepse e dinë që lufta u krye kundër makinerisë më të tmerrshme ushtarake që përdori Serbia për shfarrosjen e të tjerë popujsh në Ballkan, me besim tjetër fetar, por sidomos kundër shqiptarëve, me kombësi e gjuhë tjetër nga sllavishja.



Foto nga protesta në Prishtinë



Bajram Peçi

16 Shtator, 20:53 | Përditësimi: 16 Shtator, 21:07

f Share Tweet



A A

Kur BE, përmes përfaqësuesit të saj u kujtoi dje shqiptarve se do ketë edhe apel ndaj vendimit, kush deshi e kuptoi mesazhin? Ata dhe të tjera qeveri ishin njoftuar për dënimin e pritshëm të të gjithë zinxhirit drejtues të UÇK-së. U përforcua kjo bindje kur gjyqtari, në nisje të verdiktit, shqiptoi se "... procesi gjyqësor nuk ka të bëjë me luftën çlirimtare dhe Kosovën", gjë që vete ai nuk e beson! Ajo çka kuptohet më qartazi, tani pas vendimeve, është ndikimi i tmerrshëm që ka Rusia mbi Europën (që vazhdon luan rolin e xhandarit) si dhe qëndrimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (vëndi i cili e ka krijsën e vet Kosovën e lirë), e flashkët, me mungesë vullneti dhe autoriteti për të penguar marrëzinë e disa punonjësve, veshur me toga. Me toga gjyqtarësh, por sa rrogëtarë aq dhe të ndikueshëm politikisht (siç ndodh kudo).

U përmendën krime që ka bërë UÇK. Nuk kam pse e vë në dyshim se ka patur apo nuk ka patur vrasje, por luftë ka qenë! Janë vrarë pa gjyq bashkëpunorë të pushtuesit dhe pas hyrjes së trupave të KFOR-it kanë ndodhur krime që askush nuk mund t'i kontrollonte. Thaçi me Krasniqin, jo që jo! Kështu ka ndodhur në çdo luftë. 14 mijë të tillë u vranë në Francë pas çlirimit dhe kapitullimit të Gjermanisë në Luftën e Dytë Botërore, ish bashkëpunorë të pushtuesit nazist.

Mjerimi i vendimeve të Gjykatës së Hagës, cilësohet i tillë sepse e dinë që lufta u krye kundër makinerisë më të tmerrshme ushtarake që përdori Serbia për shfarrosjen e të tjerë popujsh në Ballkan, me besim tjetër fetar, por sidomos kundër shqiptarëve, me kombësi e gjuhë tjetër nga sllavishja. Drejtohej sundimi dhe genocidi kundër një race tjetër, popullit shqiptar, duke e ditur se ishte i paarmatosur, i pa mbrojtur, pa përkrahjen e një shteti me peshë ndërkombëtare. Dhe do ta kishin bërë realitet shfarrosjen e kombit shqiptar, nëse NATO, nën drejtimin e Amerikës, nuk do kishte ndërhyrë!? Më kujtohen mirë vitet para kësaj kohe, kur Europa bënte sehir, ndërkohë që shqiptarëve në Kosovë ju mbyllën shkollat, u larguan nga çdo punë dhe burgjet u tej mbushën. Do mjaftonte akuza se kishin përdorur flamurin e kuq me shkabën e zezë dykrerëshe ose dhe pa asnjë akuzë madje?





LEXO EDHE:

Kosovë/ 'Jo në emrin tim', mijëra qytetarë sërish protestë në mbështetje të ish krerëve të UÇK-së! Thirrje institucioneve të veprojnë

Për të shpjeguar pse shqiptarët ngelën si jetimë, do i sjell lexonjësit disa momente historike!?

Në vitin 1536, pas përqesimit të marrëdhënjëve me Austrinë, Franca, atëbotë lider ushtarak dhe udhëheqës e botës së krishterë, nën sundimin e Fransit të Parë nënshkroi me Sulejmanin e Madhërisëm të Perandorisë Otomane, Aleancën Franko-Osmane. Kjo aleancë politike, ushtarake dhe ekonomike, ishte kapaku i varrit për popujt e krishterë ballkanas, që kishin rënë nën sundim turk. Ngelën të tilla, në robëri për 450-500 vjet. Vetëm Franca kishte kapacitetet ushtarake ta çlironte Ballkanin. Të tjerat, Austria, Venediku, Gjenova, as që llogariteshin, deri kur Rusia u forcua së tepërmi, mori nën shtetull popujt sllavë në Ballkan, siç kish ndodhur me Greqinë, që u vendos nën mbret dhe ombrellë gjermane. "Turqia e vogël"-Shqipëria, pjesërisht e islamizuar, vetëm sa ju mbrojti bregdeti, për interesat austriako-italiane, të cilët nuk vonuan ta pushtojnë.

Shqipëria shtet, por jo komb-shtet, sepse gjysma e saj ngeli jashtë, ishte tërë kohën lakmi e Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë. Nëse shpëtoi, kjo nuk ndodhi për meritë të saj, por nga shkak i statukuosë së vendodur në luftën e ftohtë, NATO-Traktat i Varshavës ose me saktë, Bashkim Sovjetik! Aktualisht bota, që siç e shohim nuk është më ajo e para, po ndryshon me ritme të shpejta. Deri tani, si anëtarë të NATO-s dhe si partnerë strategjikë me SHBA, i jepnim vetes siguri. Nuk mjafton më! Gjykata e Hagës, me vendimin që mori, tërthorazi na bën me dije kërcënimin, retë e zeza mbi kryet tanë dhe na ndërmend kujdesin që duhet të tregojmë për ushtrinë, për armatimin, për vemendjen nga kurthet serbe e më gjerë.

Ajo që nuk na thotë, por që e marrim me mend është uniteti kombëtar! Nuk mjafton në të dy shtetet shqiptare vetëm një shoqëri e përçarë politikisht, me unitet të cënuar rëndë, por mbajmë në shpinë dhe sjelljet foshnjëake të drejtuesve qeveritarë. Njëri ndërton hapësira "bashkëpunimi" me Vuçiç, pa përfilluar dhe pa kaluar të vëllai më i vogël, sepse nuk e gjykon të nevojshme, ndërsa tjetri, si fëmijë qefprishur, përmes sjelljes i përcjell publikut mërinë ndaj vëllait të madh. Dhe sikur këto të mos ishin të mjafta, shohim se si raportet e Republikës së Kosovës me SHBA-në kanë rënë në nivelet më të ulta? Kosovës, që vuan prej një kohe të gjatë krizën qeveritare e të presidentit, i shtohen tani dhe pakënaqësia që do shoqërojnë në popull vendimet për katër krerët e UÇK-së.

M'u duk se kaloi pa u vënë re qëndrimi i AfD-Alternativa për Gjermaninë, partia që fitoi në Saksoni-Anhalt? Si parti me karakter ekstremisht të djathtë, ajo tronditi opinionin shqiptar kur deklaroi se do

kërkojë zyrtarisht tërheqjen e njohjes për Kosovën. Nuk pashë asnjë prononcim prej republikave tona, ta dimë: pse e kërkon kjo parti këtë gjë? Pasojat dihen. Serbia, prej lakmive të saj, ekstremizmit nationalist, urrëjtjes racore, ka provokuar dy lufta botërore. Ky deklarim i AfD-së i ngjall Serbisë shpresa se një ditë do kthehet në Kosovë. Përderi sa e thotë gjermani, pse jo?!

Organizmat tona kanë gjithçka, kohë, mjete, mëndësi dhe praktikë për ta vënë në shërbim të begatisë kombëtare. Gjëja më e zgjuar që ndodhi gjatë këtij viti ishte marrëveshja në fushën e mbrojtjes përmes Kroacisë, Shqipërisë dhe Kosovës. Një marrëveshje kjo rajonale, e cila kërkoi dhe mori miratim në NATO-s. Pas vendimit të Gjykatës së Hagës nuk dimë se çka do bëjë Serbia, Dimë se po armatoset rëndshëm dhe po i përdori, kundër nesh do e bëjë? E njohim dhe nuk i kemi besë.

Nuk është aspak e tepërt ta mbyll me vlerësimin se Gjykata e Hagës, me vendimin e marrë, i bëri një dëm shumë të madh paqes në rajon, sepse nuk dënoi katër veta, por (ndonëse nuk do ta pohojnë kurrë), por dënoi luftën e armatosur të një populli për liri.

S.I.E./Shqiptarja.com

TAG: Gjyqi ndaj UCK ne Hage

bajram peci

Sa e vlerësoni këtë artikull?



4.4 / 5 (65 vlerësime)

OPINIONET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

22 Shtator, 16:08

Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?

Po

Jo

Disi

Lajme të tjera





Këmbanat e alarmit në Ballkan



23 Shtator, 18:51



Dialogu Kosovë-Serbi, Kallas kërkon përparim pas takimeve të ndara me Kurtin dhe Vuçiçin: Marrëveshjet e arritura nga BE janë detyruese

23 Shtator, 08:43



Verdikti i Hagës, nis beteja në Apel për ish-krerët e UÇK-së

22 Shtator, 16:03



Çfarë parashikon nisma e PDK-së për ndryshime në ligjin për Specialen?

22 Shtator, 07:36



Kurti takohet me Erdoganin në SHBA: Diskutuam edhe për aktgjykimin e Speciales

22 Shtator, 07:24



Nisma e ndryshimeve ligjore për Specialet, PDK 'ofertë' Kurtit: Tërheqim padinë në Kushtetuese nëse e votoni

22 Shtator, 07:17



Rreziku nga hapja e 'Kutisë së Pandorës' në Kosovë!



22 Shtator, 07:12



Kosovë/ 'Liria ka emër', mijëra qytetarë sërish në protestë në mbështetje të ish krerëve të UÇK-së

21 Shtator, 21:54



Alban Daci: A mund të falet një person i dënuar nga Dhomat e Specializuara të Kosovës?



21 Shtator, 21:00



Hagë/ Ish-këshilltari takon Hashim Thaçin! Zbulon mesazhin e tij për popullin e Kosovës: U bëtë zëri i fuqishëm kundër padrejtësisë

21 Shtator, 20:38



Leonidha Mërtiri: Diplomacia shqiptare në betejën për drejtësi



21 Shtator, 20:07



Haga dënoi me 81 vite ish-krerët e UÇK, Rama nga SHBA: Marre ndërkombëtare, 4 burra u varrosën për së gjalli! Shqipëria qëndron krah Kosovës

21 Shtator, 19:21

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.